



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 28 Tetor 2021

Njoftim lidhur me paraqitjen e ankesave pas Shpalljes së Rezultateve të Zgjedhjeve për Kandidat për Kryetar të Komunave nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sot në ora 10:00 ka shpallur Rezultatet e Zgjedhjeve të Kandidatëve për Kryetar të Komunave për zgjedhjet Lokale të mbajtura më 17 Tetor 2021.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, njofton të gjitha palët që kanë interes juridik dhe publikun e gjerë se kundër këtyre rezultateve mund të parashtrojnë ankesë/apel në PZAP brenda afatit prej 24 orëve nga momenti i publikimit të rezultateve nga KQZ-ja.

Ankesat/apelet mund të adresohen në PZAP vetëm kundër shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve të Kandidatëve për Kryetar të Komunave e jo edhe kundër shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve të Kandidatëve për anëtar të Kuvendeve Komunale, pasi që ato nuk janë shpallur ende nga KQZ-ja, që i bie se të gjitha Kandidatet për anëtar të Kuvendeve Komunale mund të parashtrojnë ankesë/apel në PZAP, pas shpalljes së rezultateve të Kandidatëve për anëtar të Kuvendeve Komunale nga KQZ-ja.

Me respekt,